

## Basha gol me Como

nga Administrator  
E diel, 08 Maj 2016 15:42

---



Mesfushori i kombetares shqiptare Migjen Basha ka arritur te gjeje golin e pare ne kete sezon me ekipin e tij Como. Basha ka shenuar me koke ne minuten e 5 te ndeshjes Avellino - Como e vlefshme per Serie B. Ekipi i Como-s tashme ka rene nje kategori me poshte por ka marre nje barazim ne fushen e Avellino. Basha ka luajtur per 90 minuta duke qene nder me te miret per ekipin e tij.

Ne ndeshjen tjeter te Seria B, Livorno - Perugia eshte aktivizuar edhe shkodrani Armando Vajushi. Mesfushori me tipare sulmuese ka zhvilluar nje ndeshje mjaft te mire, por ne minuten e 20 te pjeses te dyte eshte demtuar duke dale nga fusha e lojes.